



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 222 Prot.

Tiranë, më datë 30.03.2022

VENDIM
Nr. 65, datë 30.03.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 30.03.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e Vendimmarrjes për projektin “Kalaja e Ishmit dhe ndërtesa pranë mureve”, Monument Kulture i kategorisë së I-rë, në kuadër të projektit “Rijetëzimi i siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga tërmeti në Shqipëri”, me aplikues dhe projektues të licencuar për ndërhyrje në pasuri kulturore personi juridik “Atelier 4” sh.p.k. dhe zhvillues “Zyrat UNOPS në Shqipëri”:
 - a. Projekti të plotësohet me variant alternativ për pikën e informacionit;
 - b. Projekti të plotësohet me variant për barrierat kufizuese në murin Jug-Perëndimor të kalasë së Ishmit;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

